



DYRRAH CITY

FOOTBALL ACADEMY

Nr. 102 prot.

Tiranë, më 24.07.2026

NJOFTIM

PËR ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Fondacioni "Dyrrah City Football Academy", në mbështetje të Rregullores së Brendshme për Administrimin e Procesit të Prokurimeve, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 7, datë 18.06.2026, si dhe bazuar në Urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv nr 31 datë 24.07.2026, njofton se është anuluar procedura e prokurimit me objekt:

"Për blerjen e shërbimeve të kontrollit mjekësor, mjekut të punës dhe mjekut sportiv për Akademinë Dyrrah City Football Academy për sezonin sportiv 2026–2027".

Arsyeja e anulimit:

Gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, Komisioni i Prokurimit konstatoi se operatori ekonomik pjesëmarrës nuk plotësonte dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, sipas Procesverbalit më datë 23.07.2026.

Fondacioni do të vijojë me rishpalljen e procedurës së prokurimit, në përputhje me dispozitat e Rregullores së Brendshme për Administrimin e Procesit të Prokurimeve.

Ky njoftim publikohet në kanalet zyrtare të komunikimit të Fondacionit për informimin e të gjithë operatorëve ekonomikë të interesua.

DREJTORI EKZEKUTIV

Jolanda Ymeri

